



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 671/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE: “Anea”Npt- Fushë Kosovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku për kontratë është rekomanduar OE- ” Link Media Plus”shpk –Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: “Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit” me nr.prok:616/18/115/221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Kuvendi Komunal i Prishtinës, më datë: 05.12.2018, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Anea”Npt- Fushë Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit” me nr.prok:616/18/115/221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Kuvendi Komunal i Prishtinës.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës i Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal i Prishtinës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit” me nr.prok:616/18/115/221.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Anea”Npt- Fushë Kosovë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 12.10.2018.

Data e njoftimi për dhënien e kontratës është bërë me dt: 07.11.2018.

Data e njoftimi me letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm është bërë me dt: 01.11.2018

Kundër njoftimit për dhënien të kontratës operatori ekonomik "Anea"Npt- Fushë Kosovë, me dt: 06.11.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 12.11.2018, Autoriteti kontraktues- Kuvendi Komunal i Prishtinës, ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik: "Anea"Npt- Fushë Kosovë, si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: "Anea"Npt- Fushë Kosovë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me dt. 19.11.2018, me nr. 671/18, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: "Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit" me nr.prok:616/18/115/221, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Kuvendi Komunal i Prishtinës duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 59, 69 dhe 72 pika 3 , të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 20.11.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese, në raportin e dt: 29.11.2018, sqaron lidhur me pretendimin e OE ankues ku thuhet se AK, ka bërë shkelje ligjore pasi që Operatori Ekonomik i propozuar për kontratë ka dorëzuar dokument pas datës së dorëzimit të ofertave, ekspertja shqyrtuese profesionale në bazë të dokumenteve të poseduara e vlerëson si të bazuar këtë pretendim ankimor, pasi që Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, sipas kërkesës së ankesit 6. në dosje të tenderit ka dorëzuar listat e kontratave të mëparshme, ku njëra nga këto kontrata ka qenë me titull: "Dekorimi i Sheshit Zahir Pajaziti – Nëna Terezë- Ibrahim Rugova" Lot I dhe II, në vlerë prej 67,008.00 euro, por nuk e ka pasur të bashkangjitur referencën për këtë kontratë, ku AK ka kërkuar letër referencën për këtë kontratë, dhe rezulton që OE i rekomanduar për kontratë e ka dorëzuar letër

referencën me datën 31.10.2018, (njëzet (20) ditë me vonesë) pas përfundimit të dorëzimit të ofertave, Ekspertja shqyrtuese konstaton se Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 72 pika 3 të LPP-së ku thuhet: “Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive”. Prandaj pasi që ky dokument nuk ka qenë i bashkangjitur në dosje të OE të rekomanduar për kontratë në ditën e hapjes së ofertave, sipas ligjit nuk është i lejuar një veprim i tillë që një dokument të ofrohet pas datës së caktuar.

Lidhur me pretendimin tjetër ankimor ku thuhet se AK tek kërkesa profesionale sipas FDT-së, ka kërkuar Licencën apo Certifikatën ISO për Ndriçim Dekorativ, dhe se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, në Certifikatën e dorëzuar nuk ka të figuruar askund veprimtarinë për “Ndriçim Dekorativ” edhe pse ka dorëzuar Certifikatën ISO e cila nuk përputhet me veprimtaritë e regjistruara në ARBK. Ekspertja shqyrtuese profesionale sqaron se AK ka bërë kërkesë për certifikatën ISO për Ndriçim Publik, andaj konstaton se OE i rekomanduar për kontratë në bazë të dokumenteve të dorëzuara ka ofruar Certifikatën ISO 9001-2015 të vërtetuar se është lëshuar nga CIB (Certificate and Inspection Bulgara), prandaj konsiderohet si valide dhe që i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit. Po ashtu për këtë Certifikatë janë provat e sakta me data të shënuara, edhe për certifikatë nga CIB edhe për konfirmim zyrtar që OE i rekomanduar është i pajisur me këtë Certifikatë. Prandaj Ekspertja Shqyrtuese Profesionale e konsideron si të pa bazuar këtë pretendim ankimor.

Ekspertja Shqyrtuese Profesionale e Prokurimit e vlerëson si pjesërisht të bazuar ankesën e OE “ANEA NPT” – Fushë Kosovë. Prandaj bazuar në gjitha konstatimet dhe sqarimet e dhëna gjatë shqyrtimit të kësaj lënde, rekomandon që autoriteti kontraktues – AK “Kuvendi Komunal i Prishtinës”, lëndën ta kthej në Rivlerësim, për aktivitetin e prokurimit: “Dekorimi i Qytetit për festa të fundvitit”, me numër të prokurimit: “616/18/115/221”, në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Operatori Ekonomik-“Anea”Npt- Fushë Kosovë, me datë: 02.12.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal i Prishtinës, me datë: 03.12.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 05.12.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti shqyrtues i OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e

lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për dhënie të kontratës, procesverbal i mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Berisha i cili deklaroj: Ne qëndrojmë pranë pretendimit tonë se AK ka bërë shkelje të procedurave. E përkrahim mendimin e ekspertit pjesërisht nën pikën e parë pajtohem ndërsa në pikën e dytë ku kërkohet certifikata ISO të ceket për ndriçim dekorativ kurse në certifikatë nuk është për ndriçim dekorativ dhe është për shitjen dhe servisimin e dritave. OE ka dorëzuar një dokument i cili është nxjerr 20 ditë më vonë ndërsa ligji thotë duhet të theksohet para datës së dorëzimit të ofertave. I propozojmë panelit që lënda të shkoj në rishqyrtim.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së, z. Bardhaj i cili deklaroj: AK me shkresën e vet lidhur me ekspertizën ka cek se nuk pajtohet me konstatimin nr.1 të ekspertizës.

Është e drejtë e secilit që ta kuptoj dhe interpretoj ligjin nga këndi i pozitës dhe profesionalizmit të vet, mirëpo besoj teksti i nenit 72 të LPP-së, për të cilin pretendohet se është shkel nga AK besoj se është keqinterpretuar edhe nga eksperti dhe nga OE ankues. Teksti sipas ligjit që qëndron edhe në ekspertizë decidivisht thotë “sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve që dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive”.

Besoj se pjesa më e rëndësishme këtij pasusi që ka të bëjë me ofrimin e informacionit dhe verifikimin në mënyrë objektive nuk është trajtuar drejtë në ekspertizë. Sqarimet prej OE janë kërkuar sipas nenit 72 të LPP-së, dhe nenit 28 të RRUOPP-së , ku decidivisht në shembullin parë thuhet “nëse ekziston lista referencave dhe kontratave por nuk ekziston dëshmia, dëshmia mund të kërkohet”. Në rastin konkret kontrata me AK do thotë me KK Prishtinë ka qenë pjesë e tenderit dhe është kërkuar dëshmia e realizimit të asaj kontrate.

Bazuar në këtë duhet të ndërlidhem me nenin 72 sepse kontrata ka të bëjë me dekorimin e qytetit për vitin 2015 dhe e drejta e çdo AK sikurse edhe ju në këtë rast do ishte të kërkoj një dëshmi se ajo kontratë është realizuar, që realisht në harmoni me nenin 72 të LPP-së, verifikohet në mënyrë objektive a është realizuar kontrata sipas kushteve të parapara apo jo. Për mua personalisht dhe për AK-në, nuk ka asnjë rëndësi se kurë dikush e ka lëshuar një referencë apo konstatim, pasi që kemi të bëjmë me kontratë të para dy viteve që është kontrata e AK-KK Prishtinë, që janë pranuar konstatimet dhe janë paguar shërbimet e kryera ndaj OE. Lidhur me këtë do kërkoja nga panelit të më mundësohet të dorëzoj dëshmitë e pagesës dhe pranimet e

shërbimeve që janë kryer në kohën kurë ka përfunduar kontrata. Si provë ja ofroj panelit dëshmitë për kryerjen e pagesave ndaj OE dhe pranimin të shërbimeve në vitin 2015.

Bazuar në këtë kërkoj nga paneli ti mundësoj AK-së vazhdimin e aktivitetit sipas propozimit të dhënë për kontratë. Sa i përket pikës së parë jemi pajtuar me konstatimet e ekspertit se certifikata është në rregull.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertja shqyrtuese znj.Jashanica deklaroj: Së pari dua të cek se nuk është kërkuar sqarime shtesë ndaj OE të rekomanduar por është kërkuar dokument shtesë.

Unë bazuar në dosjen e tenderit tek dëshmia kërkuar dokumentare ka qenë e cekur qartë “duhet ofruar listën e projekteve për tre vitet e fundit për shërbime të ngjashme me kopjet e referencave apo certifikatave”. Prandaj në raportin e ekspertizës kam cekur pasi që në dokumente të ofruara të OE të rekomanduar për kontratë ka munguar referenca kontratës së mëparshme, sipas nenit 72.3 të LPP-së, AK nuk ka drejtë të ofroj dokument shtesë, pasi që ka qenë kërkesë në dosje të tenderit të ofrohet edhe referenca. Dokumenti nuk ka qenë prezent në kohë kurë është dashur edhe pse është ofruar pas 3 ditëve sipas kërkesës së AK. Ofrimi dokumentit nga OE i rekomandua është bërë pas datës së ofertimit që me ligj nuk lejohet siç ceka paraprakisht. Po sikurse referenca të ishte prezent në dokumentet e ofruara do ti lejohej sigurimi i saj pas kërkesës së AK vetëm atëherë kurë ekzistenca e të cilës është para skadimit të afatit , e jo të ofrohet dokument pas datës së ofertimit apo siç ka pretenduar AK se kanë drejtë sigurimin e informacionit sipas nenit 72 të LPP-së. Andaj bazuar në ligj dhe ofrimin dokumentit 20 ditë me vonesë, konstatoj se qëndroj pranë raportit të ekspertizës.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, lidhur me pretendimin e OE ankues që autoriteti kontraktues ka bërë shkelje ligjore pasi që Operatori Ekonomik i propozuar për kontratë ka dorëzuar dokument pas datës së dorëzimit të ofertave, paneli shqyrtues konstaton se është i pa qëndrueshëm ky pretendim i ankuesit për faktin se vet përfaqësuesi i AK-se në seancën për shkurti kryesor ka deklaruar se prej OE janë kërkuar sqarime sipas nenit 72 të LPP-së, dhe nenit 28 të RRUOPP-së ,

Ku autoriteti kontraktues në seancën e shqyrtimit kryesor para panelit shqyrtues ka prezantuar dëshmitë e pagesës dhe pranimet e shërbimeve që janë kryer në kohën kurë ka përfunduar kontrata ku si provë ka ofruar dëshmitë për kryerjen e pagesave ndaj OE të rekomanduar për dhënie të kontratës dhe pranimin të shërbimeve në vitin 2015.

Paneli shqyrtues nga sqarimet e dhëna si me lart konstaton se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktues me ane të dëshmimeve të ofruara si më lart dhe se vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi i ofertave në këtë pike është bërë në pajtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së

Sa i përket pretendimit të OE ankues ku pretendon se tek kërkesa mbi mundësin teknike dhe profesionale sipas FDT-së, autoriteti kontraktues ka kërkuar Licencën apo Certifikatën ISO për Ndriçim Dekorativ dhe OE i rekomanduar për kontratë, në Certifikatën e dorëzuar nuk ka të figuruar askund veprimtarinë për “Ndriçim Dekorativ” edhe pse ka dorëzuar Certifikatën ISO e cila nuk përputhet me veprimtaritë e regjistruara në ARBK. Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion konstaton se AK në dosjen tenderit dhe njoftimin për kontratë është specifikuar :certifikatë apo Licencë ISO për Ndriçim Publik, dhe OE i rekomanduar për kontratë në bazë të dokumenteve të dorëzuara ka ofruar Certifikatën ISO 9001-2015 të vërtetuar se është lëshuar nga CIB (Certificate and Inspection Bulgara), prandaj konsiderohet si valide dhe që i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit. Po ashtu për këtë Certifikatë janë provat e sakta me data të shënuara, edhe për certifikatë nga CIB edhe për konfirmim zyrtar që OE i rekomanduar është i pajisur me këtë Certifikatë. Andaj paneli shqyrtues konstaton se nuk është i qëndrueshëm pretendimi i OE ankues sa i përket certifikatës se cekur si më lart.

Paneli shqyrtues me rastin e vendosjes dhe vendimmarrjes lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë mori parasysh edhe nenin 104 par. 4 pika (iii) të LPP-së, ku thuhet: *“Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara në këtë Pjesë IX, OSHP duhet (iii) të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”*. Në rastin konkret paneli shqyrtues ka pasur parasysh edhe disa kërkesa nga KK Prishtine për përshpejtim të lëndës me arsyetimin se, nëse lënda kthehet në rivlerësim atëherë nuk ka kurrfarë efekti edhe nënshkrimi i kontratës sepse mund të kalojë edhe viti i ri. Paneli shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe dispozitën e lartpërmendur ligjore, edhe pse këto rrethana mund t’u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimit ose lëshimeve të autoritetit kontraktues, sepse autoriteti kontraktues në planifikimin e prokurimit e ka paraparë edhe ndriçimin publik (ashtu siç bëhet çdo vit) dhe është dashtë të iniciojë këtë aktivitet më herët dhe të marrë parasysh mundësitë e ankesave eventuale dhe kohëzgjatja e zgjidhjes së ankesave, për të pasur një realizim më të saktë dhe me kohë të këtij aktiviteti të prokurimit

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Po ashtu autoritetet kontraktuese ka vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu autoriteti kontraktues ka vepruar në pajtim me nenin 59 dhe 60 te LPP-së për faktin se ka rekomanduar për dhënie te kontratës operatorin ekonomik i cili ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe ka ofertuar me çmim me te lire nga te gjithë ofertuesit e përgjegjshëm.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK - Kuvendi Komunal i Prishtinës
- 1x1 OE - "Anea"Npt- Fushë Kosovë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.